**UDHËZIM**
**Nr. 72, datë 18.5.2022**

# PËR PROCEDURAT PËR PAJISJEN ME LETËRNJOFTIM ELEKTRONIK DHE DOKUMENT UDHËTIMI TË PERSONAVE QË KANË PËRFITUAR STATUSIN E REFUGJATIT DHE MBROJTJES PLOTËSUESE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të pikës 5, të nenit 91, të ligjit nr. 10/2021, "Për azilin në Republikën e Shqipërisë", dhe të ligjit nr. 10129, datë 11.5.2009, "Për gjendjen civile", të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Personi që ka fituar status refugjati apo mbrojtje plotësuese në Republikën e Shqipërisë, i cili identifikohet me anë të lejes së qëndrimit dhe vendimit të statusit, paraqet kërkesën për pajisje me letërnjoftim elektronik dhe/ose dokument udhëtimi pranë autoritetit përgjegjës për azilin dhe refugjatët.
2. Pas marrjes së kërkesës për pajisjen me dokument udhëtimi dhe/ose letërnjoftimi elektronik, autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët kryen verifikimet e nevojshme dhe përcjell pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile kërkesën me të dhënat përkatëse të personave me status refugjati dhe mbrojtje plotësuese.
3. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile i paraqet kompanisë koncesionare kërkesën për rezervimin e takimit për aplikim.
4. Personi me status refugjati apo mbrojtje plotësuese aplikon për letërnjoftim elektronik dhe/ose dokument udhëtimi në zyrën përkatëse të aplikimit pranë Njësisë Administrative nr. 10, Tiranë.
5. Personi, nën moshën 16 (gjashtëmbëdhjetë) vjeç, aplikon vetëm për dokument udhëtimi me kërkesë dhe në praninë e të paktën njërit prej prindërve, të kujdestarit ose të përfaqësuesit ligjor me prokurë të posaçme.
6. Personi, deri në moshën 12 (dymbëdhjetë) vjeç, pajiset me dokument udhëtimi pa i marrë gjurmët daktiloskopike, ndërsa mbi këtë moshë është e detyrueshme marrja e tyre.
7. Vlefshmëria e dokumentit të udhëtimit për personin nën moshën 16 (gjashtëmbëdhjetë) vjeç është 5 (pesë) vjet, ndërsa vlefshmëria e dokumentit të udhëtimit dhe e letërnjoftimit elektronik për personin mbi këtë moshë është 10 (dhjetë) vjet për secilin dokument.
8. Aplikuesi e blen kuponin e posaçëm nga çdo subjekt i autorizuar për shpërndarjen e tij.
9. Pajisja me letërnjoftim elektronik bëhet vetëm për personin që ka fituar statusin e refugjatit apo mbrojtjen plotësuese dhe është mbi moshën 16 (gjashtëmbëdhjetë) vjeç.
10. Pajisja me letërnjoftim elektronik dhe/ose dokument udhëtimi kryhet brenda 15 ditëve nga data e aplikimit.
11. Tërheqja e letërnjoftimit elektronik kryhet nga vetë personi, në zyrën përkatëse të aplikimit pranë Njësisë Administrative nr. 10, Tiranë.
12. Tërheqja e dokumenteve të udhëtimit kryhet në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë, nga personi ose i ngarkuari me prokurë të posaçme apo një pjesëtar i afërt i familjes (bashkëshortja/prindi, fëmija madhor) apo kujdestari ligjor për të miturit.
13. Personi ripajisjet me letërnjoftim elektronik dhe/ose dokument udhëtimi para mbarimit të afatit të vlefshmërisë së dokumenteve ekzistuese, vetëm në rastet e mëposhtme:
    a) kur ndryshojnë përbërësit e gjendjes civile;
    b) kur dokumentet janë deklaruar të humbura;
    c) kur dokumentet janë kallëzuar të vjedhura;
    ç) kur dokumentet janë dëmtuar fizikisht.
14. Pas lëshimit të dokumentit të udhëtimit, në Sistemin e Kontrollit të Kufirit (TIMS) kryhet transferimi i të dhënave *online,* nëpërmjet përditësimit të procedurës aktuale për transferimin e të dhënave të dokumenteve të lëshuara për këtë kategori personash.
15. Autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët njofton Shërbimin Informativ të Shtetit për dokumentet e lëshuara dhe mbajtësit e tyre.

16. Autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët njofton Drejtorinë e Mbrojtjes dhe Përpunimit të të Dhënave në Policinë e Shtetit për shënime të veçanta, për çdo dokument të lëshuar për këta persona.

17. Për çdo ndryshim në statusin e personit të pajisur me letërnjoftim elektronik dhe/ose dokument udhëtimi, autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët njofton Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile, Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe Shërbimin Informativ të Shtetit për pasqyrimin e këtij ndryshimi në bazën e të dhënave.

18. Udhëzimi i ministrit të Punëve të Brendshme nr. 346, datë 27.11.2014, "Për procedurat për pajisjen me letërnjoftim elektronik dhe dokument udhëtimi të shtetasve që kanë përfituar statusin e refugjatit dhe mbrojtje plotësuese në Republikën e Shqipërisë", shfuqizohet.

19. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BRENDSHËM
**Bledar Çuçi**